



SPECIALJA NUK E LEJOI TA VIZITONTE, VDES BABAI I SALIH MUSTAFËS

FAQE 5



Jahja Mustafa, babai i Salih Mustafes, ka ndërruar jetë. Lajmin e ka konfirmuar Hysni Gucati, kryetari i OVLUCK-së, i cili ka shprehur ngushëllime për familjen dhe miqtë e të ndjerit. Ndërkaq në një reagim OVLUCK ka shprehur indignatën dhe shqetësimin e thellë për refuzimin e Dhomave të Specializuara në Hagë që t'i mundësojnë Salih Mustafës një vizitë humanitare pranë babait të tij, i cili tashmë ka ndërruar jetë, pa e parë dhe pa i dhënë lamtumirën e fundit të birit

**AMBASADORI I
FRANCËS,
OLIVIER GUEROT:
NA DUHET NJË
QEVERI ME
KOMPETENCA TË
PLOTA NË KOSOVË**

F. 7



**THIRRJE
PËR PAQE DHE
DHEMBSHURI
NË MESHËN E
KRISHTLINDJES**

F. 2



**NJË MILIARD EURO RRYMË TË
IMPORTUAR NË DEKADËN E FUNDIT,
SLOVENIA FURNIZUESI KRYESOR I
KOSOVËS**

F. 8

SPORT



**ZYRTARE: LINDON EMERLLAHU
TRANSFEROHET TE POLISSYA
ZHYTOMYR**

F. 9

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

THIRRJE PËR PAQE DHE DHEMBSHURI NË MESHËN E KRISHTLINDJES

VATIKAN, 25 DHJETOR - Papa Leoni XIV ka mbajtur meshën e parë të Krishtlindjes në rolin e kreut të Selisë së Shenjtë në mesnatë, duke mirëpritur mijëra besimtarë të mbledhur në Sheshin e Shën Pjetrit në Vatikan. Përgjatë meshës, Leoni ka thënë se Krishtlindja është festë e “besimit, bamirësisë dhe shpresës” dhe e ka kritikuar “ekonominë e shtrembëruar” që “na çon drejt trajtimit të njerëzve si mallra të thjeshta”. “Në Tokë nuk ka vend për Zotin nëse s’ka vend për njeriun. Refuzimi i njërës e refuzon tjetrin”, ka thënë Papa. Para se të niste meshën, ai i ka falënderuar rreth 5.000 persona që janë mbledhur afër objektit të bazilikës, pavarësisht motit me shi.

Papa amerikan e ka adoptuar një qasje më moderne në krahasim me paraardhësin e tij karizmatik, Papa Françeskun, i cili vdiq më 21 prill. Në meshë kanë marrë pjesë figura të larta kishtarë, diplomatë dhe mijëra besimtarë tjerë. Në ceremoni është festuar lindja e Jezu Krishtit, dhe kjo është ndër ditët më të rëndësishme në kalendarin e Kishës Katolike. Krishtlindja e këtij viti shënon edhe fundin e Vitit të Shenjtë Jubilar të Kishës Katolike, çka ka rezultuar me dyndje të miliona pelegrinëve në Romë. Në Kosovë, ceremonia kryesore është mbajtur në Katedralen Shën Tereza në Prishtinë. Ceremonia është drejtuar nga ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë



Gjergji. Aty kanë marrë pjesë figura kryesore shtetërore, përfshirë presidenten e vendit, Vjosa Osmani dhe dhjetëra besimtarë. “Krishtlindja është frymëzim që na kujton se edhe

përballë sfidave duhet të triumfojë shpresa. Kjo festë na fton për respekt të ndërsjellë ndaj familjes që na do pa kushte, ndaj miqve që na qëndrojnë pranë, dhe bashkëkombësve tanë me të

cilët na lidh gjuha, gjaku dhe shpresa e përbashkët”, ka thënë presidentja Osmani. Më herët gjatë këtij muaji, presidentja e ka takuar personalisht Papa Leonin XIV, të cilit i ka kërkuar njohjen e shtetësisë së Kosovës nga ana e Vatikanit. Pavarësisht se Vatikani nuk e njeh Kosovën, dy vendet mbajnë raporte mes vete. Në janar të vitit 2024, Kosova ka hapur Misionin e Posaçëm në Vatikan. Ndërkaq, në maj të këtij viti, raportet janë thelluar edhe më shumë me emërimin e Luigji Biankos si nunc apostolik në Slloveni dhe delegat apostolik për Kosovën. Sipas të dhënave zyrtare, 1.7 për qind e popullsisë së Kosovës i takon besimit katolik.

TENSION MBI ATLANTIK, AVIONËT RUSË I AFROHEN BRITANISË, NATO REAGON ME AVIONË LUFTARAKË

Londër, 25 dhjetor - Aeroplanë luftarakë të NATO-s janë ngritur në fluturim për t’u përballur me bombardues strategjikë rusë që fluturuan pranë ujërave britanike në Ditën e Krishtlindjeve, duke shkaktuar shqetësim në qarqet ushtarake dhe diplomatike të Evropës Perëndimore. Bombarduesit rusë “Tu-95MS”, të cilët kanë kapacitet për të mbajtur armë bërthamore janë dërguar në një fluturim të gjatë mbi Detin Barents dhe Detin Norvegjez, në veri të Skocisë, afër hapësirës ajrore britanike. Ky lloj aeroplani përdoret shpesh nga Rusia për misione të zbulimit dhe të demonstrimit të forcës, duke rritur tensionet në rajon. Sipas Ministrisë Ruse të



Mbrojtjes, bëhej fjalë për një “fluturim të planifikuar” mbi ujërat neutrale, por zyrtarët perëndimorë e vëzhguan fluturimin dhe vendosën masa monitorimi, duke ndjekur çdo

lëvizje të bombarduesve rusë nga ajri dhe radarët tokësorë. Gjatë misionit, bombarduesit janë shoqëruar nga avionë luftarakë rusë “Su-33”, të cilët ofruan mbështetje dhe

siguruan një korridor të sigurt për aeroplanët strategjikë. Fluturimi ka zgjatur më shumë se shtatë orë, duke përfshirë kalimin pranë disa zonave të rëndësishme ushtarake dhe

kufijve të hapësirës ajrore të vendeve aleate. NATO ka reaguar shpejt, duke ngritur aeroplanë luftarakë përgjigjeje për të monitoruar dhe shoqëruar avionët rusë. Sipas burimeve zyrtare, bombarduesit nuk hynë në hapësirën ajrore sovranë të Mbretërisë së Bashkuar, por janë afruar mjaft pranë zonës së interesit strategjik të saj, duke vënë në gatishmëri forcat e mbrojtjes ajrore dhe duke rritur vigjilencën në të gjithë rajonin. Ngjarja vjen në një kohë tensioni të shtuar midis Rusisë dhe aleatëve të NATO-s, duke treguar se kontrolli mbi hapësirën ajrore dhe reagimi i shpejtë mbeten elementë kyç për sigurinë kombëtare dhe stabilitetin e rajonit.

TURQIA ARRESTON 115 PJESËTARË TË DYSHUAR TË IS-it QË “PLANIFIKONIN SULME PËR VITIN E RI”

ANKARA, 25 DHJETOR - Autoritetet turke kanë bërë me dije se kanë penguar disa sulme të planifikuara për ditët e Krishtlindjes dhe Vitit të Ri, duke arrestuar më shumë se 100 anëtarë të dyshuar të grupit ekstremist, Shteti Islamik (IS). Bastisjet masive janë kryer në 124 adresa nëpër Stamboll, ka bërë të ditur kryeprokurori i qytetit. Në aksion janë konfiskuar armë zjarri, municione dhe “dokumente organizative”. Zyrtarët kanë thënë se mbështetësit e IS-it kanë qenë duke planifikuar në mënyrë aktive sulme nëpër Turqi këtë



javë, sidomos kundër atyre që nuk i përkasin besimit islam. Policia i ka arrestuar 115 të

dyshuar, mirëpo përpjekjet janë duke vazhduar për t’i arrestuar edhe 22 të tjerë, është thënë në

deklaratë. Zyra e Prokurorit ka thënë se të dyshuarit kanë qenë në kontakt me operativë të IS-it jashtë Turqisë. Ky njoftim vjen dy ditë pasi agjentë të inteligjencës turke kanë kryer bastisje kundër grupit në kufirin afgano-pakistanez. Një shtetas turk që dyshohet të ketë pasur rol me rëndësi në një krah të IS-it në rajon, është ndaluar dhe është akuzuar për planifikim të sulmeve kundër civilëve. Shërbimet turke të sigurisë shënjestrojnë rregullisht të dyshuar për lidhje me IS-in. Turqia ndan një kufi prej 900 kilometrash me Sirinë, ku grupi

vazhdon të operojë në disa rajone. Presidenti i Sirisë, Ahmed al-Sharaa, i cili ka lidhje të ngushta me Qeverinë turke, është zotuar se do të punojë me Shtetet e Bashkuara dhe Evropën për t’i çrënjosur elementët e IS-it që kanë mbijetuar. ShBA-ja ka nisur një valë sulmesh kundër pozicioneve të grupit nëpër Siri ditë më parë, si përgjigje ndaj vrasjes së tre amerikanëve. Dy ushtarë amerikanë dhe një përkthyes civil janë vrarë nga sulmues të armatosur të IS-it më herët gjatë këtij muaji.

NGA PRITJET E MËDHA TE ZHGËNJIMI: SERBIA DHE ADMINISTRATA E TRUMPIT

UASHINGTON, 25 DHJETOR - Nga bilbordet me mesazhin “Trump, serb”, te zhgënjimi.

Sanksionet ndaj Industrisë së Naftës së Serbisë (NIS), tarifatat për produktet nga Serbia, që janë më të lartat në rajon, si dhe bllokimi i importeve të gomave të automobilave nga fabrika kineze Linglong në Serbi, janë masa që administrata amerikane ka ndërmarrë që kur Donald Trump mori mandatin më pak se një vit më parë.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tani e pranon se në vend të përparimeve të mëdha të pritura, nga administrata Trump kanë ardhur vendime që nuk janë në interes të Serbisë.

Ky vlerësim vjen një vit pas zgjedhjeve amerikane, kur në Beograd fitorja e Trumpit u “festua” me pritjen për një qëndrim më të favorshëm ndaj Serbisë. “Mendoj se [Vuçiq] donte që Trump ta pranonte dhe ta shihte si figurë kyç të paqes në rajon. Duhet të jetë i zhgënjyer që kjo nuk ndodhi”, vlerëson për Radion Evropa e Lirë profesori Daniel Serwer nga Universiteti Johns Hopkins në Shtetet e Bashkuara.

Departamenti amerikan i Shtetit i referohet Ambasadës në Beograd

Departamenti amerikan i Shtetit nuk iu përgjigj drejtpërdrejt pyetjes së Radios Evropa e Lirë për komentet e presidentit të Serbisë, por u referua te një deklaratë e Ambasadës amerikane në Beograd.

Në atë deklaratë u transmetua fjalimi i të ngarkuarit me punë, Aleksandar Titolo, në hapjen e një pjese të Korridorit të Moravës pranë Vërnjačka Banjës, në Serbinë qendrore, më 24 dhjetor.

Titolo tha atëbotë se nën udhëheqjen e Vuçiqit dhe Trumpit, bashkëpunimi mes Serbisë dhe SHBA-së është tani “më i fortë se kurrë dhe sot mund të shohim disa nga frytet konkrete të partneritetit tonë të fortë dhe në rritje”.

Punimet në Korridorin e Moravës i kryen konsorciumi amerikano-turk Bechtel-Enka, ndërsa Titolo shtoi se viti 2025 ishte “një vit i rëndësishëm, sepse kemi hyrë në një epokë të re të marrëdhënieve mes SHBA-së dhe Serbisë”. “Këtë vit patëm takime historike në nivel të lartë mes zyrtarëve amerikanë dhe serbë. Të përmendim vetëm takimin mes sekretarit amerikan të Shtetit dhe ministrit të Jashtëm të Serbisë, i pari pas pothuajse dy dekadash. Ne kemi njoftuar edhe për Dialogun e ri Strategjik mes dy shteteve tona”, shtoi ai.

SHBA-ja zhvillon Dialog Strategjik me dhjetëra vende të botës me qëllim përmirësimin e raporteve dypalëshe. Nga



vendet e rajonit, dialog strategjik me Uashingtonin kanë zhvilluar Rumania dhe Sllovenia - anëtare të Bashkimit Evropian - si dhe Maqedonia e Veriut, e vetmja nga Ballkani Perëndimor. Megjithatë, fakt është se SHBA-ja nuk ka ambasador në Serbi prej gati një viti.

Edhe pse Trump në mars e kishte nominuar republikanin Mark Brnovich për atë post, në fillim të tetorit administrata e tërhoqi këtë propozim, pa dhënë ndonjë arsye.

Pse Beogradi kishte pritje të mëdha nga Trumpi?

Kur Donald Trump u rikthye në Shtëpinë e Bardhë në janar, përfaqësuesit nga pushteti në Serbi nuk e fshehën gëzimin. Presidenti Vuçiq deklaroi se në një bisedë telefonike me Trumpin kishte theksuar se Serbia ishte vendi ku ai kishte mbështetjen më të madhe në të gjithë Evropën. “Jam i sigurt se, me mbështetjen e miqve, dhe me miq nënkuptoj gjithë rrethin e presidentit Trump, do të mund ta bëjmë atë ta bëjë Amerikën Madhështore, ndërsa ne ta bëjmë Serbinë një vend të dinjitetshëm që do të bashkëpunojë shumë mirë me Shtetet e Bashkuara”, shkroi Vuçiq më 11 nëntor 2024 në Instagram pas asaj bisede. Një vit më vonë, në një fjalim në Konferencën e Ambasadorëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë në Beograd, Vuçiq tha se deri më tani nuk ka përparime.

Ish-ambasadori i Serbisë në Uashington, Ivan Vujačić, thotë për REL-in se sot marrëdhëniet Serbi-SHBA nuk janë aspak të mira, gjë që e shpjegon me tarifatat më të larta në rajon, sanksionet ndaj NIS-it dhe ndalimin e gomave të Linglong-ut. “Ka pasur mbështetje për Trumpin dhe u krijua një opinion publik që shpresonte

se ai do të kishte shumë më tepër mirëkuptim për Serbinë në një sërë çështjesh. Kjo doli të jetë e pasaktë”, u shpreh ai.

Ai shton se është tentuar afrimi me administratën Trump përmes projektit të revitalizimit të kompleksit të Shtabit të Përgjithshëm, duke vlerësuar se kjo u bë në një “mënyrë të keqe”. “Dhëndri i Trumpit në një moment kuptoi se po futej në një situatë që kishte elementë korrupsioni dhe vepra penale dhe u tërhoq”, thekson ai.

Kompania Affinity Partners e Jared Kushnerit, dhëndrit të presidentit amerikan, njoftoi së fundi se heq dorë nga ndërtimi i një kompleksi luksoz në qendër të Beogradit në vendin e ish-Shtabit të Përgjithshëm, të shkatërruar në bombardimet e NATO-s më 1999.

Më herët, Prokuroria në Serbi ka akuzuar ministrin e Kulturës të Serbisë, Nikolla Sellaković, për falsifikim dokumentesh mbi bazën e të cilave Shtabi i Përgjithshëm e humbi statusin e trashëgimisë kulturore. Zyrtarët e justifikuan projektin me pretendimin se ai do t'i afronte marrëdhëniet mes Serbisë dhe SHBA-së, duke akuzuar kundërshtarët se e kishin sabotuar dhe kishin larguar investitorët.

I pyetur pse në Beograd besonin se Trumpi do të mbante një qëndrim më të favorshëm ndaj Serbisë, Serwer thotë se ata ishin ndier se ishin trajtuar mirë gjatë mandatit të parë presidencial të Trumpit. “Dhe shpresonin se interesat e familjes Trump në Beograd do të mbizotëronin”, thekson ai.

Më vonë, më 23 shtator, Vuçiq u takua në Nju Jork me sekretarin amerikan të Shtetit, Marco Rubio, në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Sipas Vuçiqit, ata diskutuan për forcimin e dialogut politik, përmirësimin e bashkëpunimit

ekonomik dhe sfidat e përbashkëta të sigurisë, me fokus në zgjidhjen e çështjes së tarifave amerikane.

Administrata amerikane në prill i vendosi Serbisë tarifën më të lartë në rajonin e Ballkanit Perëndimor – 37 për qind.

Pak para se Vuçiq të pranonte se nga Uashingtoni nuk kishte përparime siç priste, Doganat dhe Mbrojtja e Kufijve e SHBA-së urdhëroi ndalimin e importit të gomave të prodhuara në Serbi, për shkak të dyshimeve për punë me detyrim.

Po ashtu, si pasojë e sanksioneve amerikane ndaj NIS-it për shkak të pronësisë shumicë ruse, u pezullua puna e rafinerisë së NIS-it për përpunimin e naftës së papërpunuar.

Sa e rëndësishme është Serbia për SHBA-në?

I pyetur për të ardhmen e marrëdhënieve serbo-amerikane, ish-ambasadori Ivan Vujačić thotë se SHBA-ja nuk e ka shumë në qendër të vëmendjes Serbinë. “Nuk jemi shumë lart në radarin e tyre”, shprehet ai. “Gjërat po ndodhin sipas një inercie që vjen ende nga administrata Biden, si sanksionet ndaj rusëve, por në thelb kjo është presion ndaj Rusisë në kuadër të përpjekjeve për paqe në Ukrainë”, shton Vujačić.

Nga ana tjetër, ekziston edhe animoziteti ndaj Kinës. “Kështu që ndikimi kinez këtu, sidomos investimet kineze, nuk do të shihen me sy të mirë”, vlerësoi Vujačić.

Serbia është kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian, por që nga dhjetori 2021 nuk ka hapur asnjë kapitull negociues. Kjo kryesisht për shkak të refuzimit për të vendosur sanksione ndaj Rusisë për pushtimin e

Ukrainës, si dhe për shkak të marrëdhënieve të pazgjidhura me Kosovën dhe gjendjes së demokracisë dhe sundimit të ligjit në vend.

Përveç kësaj, Serbia po forcon bashkëpunimin me Kinën – politik, ekonomik dhe vitet e fundit edhe bashkëpunimin ushtarak.

Profesori amerikan Daniel Serwer thotë se ekziston pakënaqësi e qartë, dypartiake, në Kongres dhe në Departamentin e Shtetit ndaj Serbisë dhe sjelljes së saj. “Serbia është një vend kyç në Ballkan, por për sa kohë që zgjedh të rreshtohet me Rusinë dhe Kinën, mund të presë marrëdhënie të ftohta nga ata në SHBA që ndjekin zhvillimet në Ballkan”, thotë Serwer. I pyetur nëse rëndësia e Serbisë ka ndryshuar krahasuar me administratat e mëparshme, Serwer vlerëson se “ndoshta ka ndryshuar perceptimi i Uashingtonit për vullnetin e mirë të Beogradit”.

“‘Loja e dyfishtë’ e Vuçiqit lidhur me Ukrainën dhe shkaktimi i problemeve në Kosovë kanë hedhur një hije të madhe. Heqja e saj kërkon vendime që Vuçiq, me sa duket, nuk është i gatshëm t’i marrë. Pres që ai të provojë, ndoshta me metodat e Dodikut: lobistë të shtrenjtë dhe marrëveshje jotransparente”, shton ai.

Shtetet e Bashkuara në fund të tetorit i hoqën nga lista e sanksioneve Millorad Dodikun, anëtarin e Presidencës së Bosnjë e Hercegovinës Zhenka Cvijanović, anëtarë të familjes së Dodikut, kompanitë e tyre dhe bashkëpunëtorët të afërt.

Dodik ishte sanksionuar për veprimtari kundër Marrëveshjes së Dejtonit, pra për minimin e shtetit të Bosnjë e Hercegovinës, ndërkaq Departamenti i Shtetit e arsyetoi heqjen e sanksioneve me vendimet e Kuvendit të entitetit Republika Srpskas, duke thënë se ato duhet të “përmirësojnë stabilitetin e Bosnjë e Hercegovinës”.

Ndërkohë, presidenti amerikan Donald Trump ka nënshkruar Ligjin për Autorizimin e Mbrojtjes Kombëtare, ku përmenden edhe vendet e Ballkanit Perëndimor dhe nevoja për integrimin e tyre euroatlantik dhe uljen e varësisë energjetike nga Rusia. Në këtë ligj përmendet gjithashtu shqetësimi për gjendjen e demokracisë në Serbi dhe thuhet se Serbia dhe Kosova duhet të synojnë përparim të menjëhershëm në zbatimin e marrëveshjeve për normalizimin e marrëdhënieve. Po ashtu, theksohet se SHBA-ja duhet të vazhdojë të mbështesë arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare gjithëpërfshirëse mes Kosovës dhe Serbisë, e bazuar në njohje të ndërsjellë.



SERBËT E KOSOVËS PËRBALLË ZGJEDHJEVE: ASOCIACIONI, SIGURIA, MBIJETESA...

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Formimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe, liria, paqja, siguria dhe një perspektivë më e mirë për të rinjtë...

Këto janë pritjet e disa pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë, me të cilët bisedoi Radio Evropa e Lirë, në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit. Disa prej tyre, megjithatë, shprehin mosbesim ndaj politikanëve, të cilët, siç thonë, gjithmonë premtojnë shumë gjatë fushatave parazgjedhore. Zgjedhjet mbahen pasi Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit, e cila fitoi numrin më të madh të votave në zgjedhjet e 9 shkurtit, nuk arriti të siguronte mbështetjen e partive të tjera parlamentare për formimin e Qeverisë së re.

Kosova, po ashtu, u përball me një krizë të thellë institucionale dhe politike për disa muaj, për shkak të pamundësisë për të konstituuar Kuvendin, si pasojë e mosmarrëveshjeve mes partive shqiptare.

Për shkak të interpretimeve të ndryshme të ligjit apo Rregullores së Kuvendit, partitë, në disa raste, iu drejtuan edhe Gjykatës Kushtetuese të Kosovës - mes tjerash edhe për çështjen

e zgjedhjes së nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb.

Gjykata Kushtetuese e mori një vendim në favor të Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit - duke vlerësuar se Kuvendi nuk është i konstituuar pa zgjedhjen e nënkryetarit nga radhët e komunitetit serb.

Megjithatë, ende pritet përgjigjja nëse zgjedhja e Nenad Rashiqit nga Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë ishte legjitime.

Në zgjedhjet e shkurtit, Lista Serbe fitoi nëntë nga dhjetë ulëset e garantuara për komunitetin serb në Kuvendin e Kosovës, ndërsa një mandat i shkoi Rashiqit.

Subjektet politike serbe që do të garojnë në zgjedhjet e 28 dhjetorit, janë: Lista Serbe, Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, si dhe Aleanca Kosovare - parti e formuar në qershor të këtij viti me mbështetjen e deputetit në Kuvendin e Serbisë, Zharko Ristiç.

Analistët politikë kanë vlerësuar më herët për Radion Evropa e Lirë se, në mungesë të konkurrencës së fortë, fitorja

absolute e Listës Serbe është pothuajse e sigurt.

Prioritetet: Siguria në veri, çështjet ekonomike në jug

Sllavica nga Mitrovica e Veriut thotë se dëshirë e saj e vetme është “të jetë e sigurt në vendin e vet”. “Të kemi diçka tonën, ta dimë se jemi këtu, sepse kështu nuk e dimë ku jemi”, thotë ajo, duke shtuar se interesat dhe të drejtat e komunitetit serb në Kosovë mund të mbrohen vetëm përmes formimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Për këtë asociacion është rënë dakord në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi, me qëllim që t’u ofronte pjesëtarëve të komunitetit serb një nivel të caktuar të vetëmenaxhimit. Por, marrëveshja për të nuk është zbatuar ende në praktikë.

Jellena, në anën tjetër, nuk pret asgjë, sepse, siç thotë, është dëshmuar se “askush nuk kujdeset për popullin”. “Çfarë të pres? Asgjë. Për ne nuk ka shpresë”, thotë kjo banore e Mitrovicës së Veriut.

Ajo shton se e ka humbur besimin, pasi edhe më herët, para zgjedhjeve, janë premtuar

shumë gjëra, ndërsa në terren ka ndodhur e kundërta.

Si shembull, Jellena përmend mbylljen e institucioneve të Serbisë, heqjen e targave serbe të automjeteve nga përdorimi, si dhe heqjen e dinarit serb.

Lista Serbe, për tre vjet, i ka bojkotuar institucionet dhe proceset zgjedhore të Kosovës, pasi, paraprakisht, ka iniciuar daljen e serbëve nga institucionet, për shkak të insistimit të Qeverisë së Kosovës për heqjen e targave serbe.

Krizat kanë pasuar njëra-tjetrën, ndërsa situata ka kulmuar me sulmin e armatosur të një grupi serbësh në Banjskë të Zveçanit, në shtator të vitit 2023.

Një polic i Kosovës është vrarë në këtë sulm, kurse në përleshjen e armatosur që ka pasuar, janë vrarë edhe tre sulmues serbë.

Dragolubi, gjithashtu nga Mitrovica e Veriut, pret që pas zgjedhjeve të 28 dhjetorit të fillojë formimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe. “Pres që të jetë më mirë për serbët, që të mund t’i realizojmë të drejtat tona”, thotë ai. Nga ana tjetër, Snezhana nga Graçanica - komunë me shumicë serbe afër Prishtinës - thotë se ka liri të lëvizjes dhe bashkëjetesë me

komunitetin shumicë shqiptar, por se mungon perspektiva për të rinjtë. “Askush nuk të ngacmon, por nuk ka perspektivë. Nuk më pëlqen ajo që ndodh kur vjen koha e votimit - premtojnë gjithçka, e pastaj asgjë”, thotë ajo.

Për Raden nga Graçanica, çelësi i mbijetesës së komunitetit serb në Kosovë është punësimi i të rinjve. “Unë jam pensionist, por pres që së pari të punësohen të rinjtë. Së dyti, paqe dhe stabilitet. Shpresoj që të jetë mirë”, shprehet ai.

Çfarë thonë politikanët?

Lista Serbe, në një tubim parazgjedhor në Mitrovicë të Veriut, tha se po hyn në garë për të dhjetë vendet e garantuara parlamentare dhe se “do të mbrojmë - në çdo moment - interesat e popullit serb dhe të çdo individi”.

Zyrtari i Listës Serbe, Igor Simiq, tha se, pas zgjedhjeve, nuk do të zhiduken menjëherë të gjitha problemet e komunitetit serb, por se dhjetë deputetët do të luftojnë për të drejtat e tyre.

Ndërkohë, Komisariati për Refugjatë dhe Migrim i Republikës së Serbisë u bëri thirrje personave të zhvendosur

SPECIALJA NUK E LEJOI TA VIZITONTE, VDES BABAI I SALIH MUSTAFËS

Jahja Mustafa, babai i Salih Mustafes, ka ndërruar jetë. Lajmin e ka konfirmuar Hysni Gucati, kryetari i OVLUÇK-së, i cili ka shprehur ngushëllime për familjen dhe miqtë e të ndjerit. Ndërkaq në një reagim OVLUÇK ka shprehur indinjatën dhe shqetësimin e thellë për refuzimin e Dhomave të Specializuara në Hagë që t'i mundësojnë Salih Mustafës një vizitë humanitare pranë babait të tij, i cili tashmë ka ndërruar jetë, pa e parë dhe pa i dhënë lamtumirën e fundit të birit



PRISHTINË, 25 DHJETOR - Jahja Mustafa, babai i Salih Mustafes, ka ndërruar jetë. Lajmin e ka konfirmuar Hysni Gucati, kryetari i OVLUÇK-së, i cili ka shprehur ngushëllime të thella për familjen dhe miqtë e të ndjerit. Gucati në një postim në rrjetet sociale shkruan se dhimbja bëhet edhe më e rëndë për shkak se djali i të ndjerit, Salih Mustafa, nuk ka mundur ta vizitojë babanë në momentet e fundit për shkak të situatës me Gjykatën Speciale. “Ngushëllime të thella për

familjen, miqtë dhe të gjithë ata që e kanë njohur Bacën Jahja. Pusho në paqe, Bace!”, ka shkruar Gucati. Ndërkaq në një reagim OVLUÇK ka shprehur indinjatën dhe shqetësimin e thellë për refuzimin e Dhomave të Specializuara në Hagë që t'i mundësojnë Salih Mustafës një vizitë humanitare pranë babait të tij, i cili tashmë ka ndërruar jetë, pa e parë dhe pa i dhënë lamtumirën e fundit të birit. “Ky vendim i pashpjegueshëm dhe johuman përbën një shkelje të rëndë të

parimeve themelore të të drejtave të njeriut dhe të çdo standardi minimal të humanizmit. Salih Mustafa është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë dhe nuk ka ekzistuar asnjë rrezik për ndikim në dëshmitarë apo në ndonjë proces gjyqësor. Refuzimi i një kërkesë të tillë humanitare nuk ka as bazë ligjore dhe as morale”, thuhet

në reagim. OVLUÇK-ja shton se mohimi i së drejtës për t'i qëndruar pranë prindit në momentet e fundit të jetës dhe për t'i dhënë lamtumirën e fundit është një akt që tejkalon çdo kufi të drejtësisë dhe e zhvesh procesin nga çdo ndjenjë njerëzore. “Drejtësia pa humanizëm nuk është drejtësi, por padrejtësi e

institucionalizuar. Ngushëllime familjes Mustafa, bashkëluftëtarëve të Calit dhe të gjithë atyre që e njohën bacën Jahja”, thuhet në reagim. Indjeri ishte tash e një kohë në gjendje të rëndë shëndetësore, ndërsa djali të tij, ish-komandantit të UÇK-së, Salih Mustafa, i cili gjendet në burg në Gjykatën Speciale, nuk iu lejua vizita ditë më parë.

BEKIM JASHARI: KRAHASIMI I VEPRIMEVE TË QEVERISË SË KOSOVËS ME REGJIMIN E MILLOSHEVIQIT ËSHTË FYERJE NDAJ SAKRIFICËS KOMBËTARE

Prishtinë, 25 dhjetor- Bekim Hamëz Jashari ka reaguar ashpër ndaj deklaratave të disa individëve dhe politikanëve në Kosovë, të cilët, sipas tij, po përbuzin veprimet legjitime të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shtrirjen e sovranitetit dhe integritetit territorial në veri të vendit, duke i krahasuar ato me krimet e regjimit të Millosheviqit. Në një reagim publik, Jashari ka theksuar se një krahasim i tillë nuk përbën as padije e as lapsus politik, por një fyerje të rëndë ndaj sakrificës së popullit shqiptar. Sipas tij, është e papranueshme që veprimet e një shteti sovran, i cili po shuan struktura paralele ilegale, po vendos rend dhe ligj dhe po garanton funksionimin e institucioneve në të gjithë territorin e Kosovës, të

barazohen me sundimin dhe shtypjen e përgjakshme të Serbisë ndaj shqiptarëve. “Është e turpshme dhe e papranueshme se si disa individë e politikanë të vendit, e akoma më keq disa të tjerë që thirren si “shokë” të Kryekomandantit Adem Jashari, bëjnë deklarata që nga njëra anë përbuzin veprimet legjitime të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shtrirjen e sovranitetit dhe integritetit territorial në veri, ndërsa nga ana tjetër i krahasojnë këto veprime shtetërore me krimet e regjimit gjenocidal të Millosheviqit. Kjo nuk është as padije, as lapsus politik por fyerje e rëndë ndaj sakrificës së popullit shqiptar. Si mund të krahasohet sundimi dhe shtypja e përgjakshme e Serbisë ndaj shqiptarëve me veprimet e



shtetit tonë sovran, i cili po shuan struktura paralele ilegale, po vendos rend dhe ligj dhe po garanton funksionimin e institucioneve në çdo cep të territorit të Republikës së Kosovës? Këto deklarata i

shërbejnë drejtpërdrejt narrativës së Serbisë. Sepse Serbia dëshiron pikërisht këtë: të na shohë të përcarë, të papërgjegjshëm, të zhytur në konflikte të kota dhe larg interesave vitale të shtetit të

Kosovës. Populli na njeh mirë. Ai nuk ka harruar të bëmat e secilit prej nesh: kush kemi qenë, çfarë kemi bërë dhe si jemi sjellë ndër vite, sidomos në momentet më të vështira për vendin. Historia nuk fshihet me deklarata ditore dhe as nuk rishkruhet për interesa politike. Prandaj, bëjmë thirrje për unitet, maturi dhe përgjegjësi kombëtare. Politika duhet të jetë mjet bashkimi rreth interesave strategjike të Kosovës, e jo instrument për përcarje, relativizim të krimeve serbe dhe përfitim të ngushta partiake. Kosova ka nevojë për lidhshmëri të përgjegjshme, me dinjitet kombëtar, që i shërben shtetit dhe atdheut, jo egos personale dhe kalkulimeve politike afatshkurtra”, ka shkruar në “Facebook” Bekim Hamëz Jashari.

nga Kosova që të votojnë në zgjedhjet e Kosovës, të caktuara për 28 dhjetor, duke theksuar se çdo votë është e rëndësishme “për qëndrimin dhe mbijetesën e popullit serb”. Shteti i Serbisë, i cili i jep mbështetje Listës Serbe, është angazhuar edhe më herët për të organizuar votimin e personave të zhvendosur nga Kosova, si në zgjedhjet parlamentare të shkurtit, ashtu edhe në zgjedhjet lokale të mbajtura në tetor dhe në nëntor. Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë e Rashiqit - i cili ka

qenë pjesë e Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga Albin Kurti - premtori një të ardhme më të mirë përmes projekteve dhe ndihmës së institucioneve të Kosovës. Nga kjo parti, në fund të javës së kaluar, u bë e ditur se fokusi i fushatës do të jetë lufta “për të drejtat themelore të njeriut, mbrojtjen institucionale të popullit serb dhe lirinë e zgjedhjes pa shantazhe dhe presione”. “Ne angazhohemi për drejtësi, jetë dinjitoze, zhvillim ekonomik dhe barazi për të gjithë qytetarët”, u tha në deklaratë.

Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë shfaqti gjithashtu shpresën se qytetarët do të gjejnë forcën për t'iu rezistuar, siç tha, shantazheve dhe mashtrimeve të Listës Serbe, duke theksuar se ekziston një nevojë e madhe për ndryshime. Lista Serbe, në anën tjetër, ka akuzuar Rashiqin dhe partinë e tij për “keqpërdorim të institucioneve të Kosovës dhe blerje votash”, duke pretenduar se, së bashku me ndarjen e subvencioneve nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, po shpërndahet edhe material

zgjedhor. Disa parti politike serbe kanë akuzuar më herët Listën Serbe për keqpërdorim të burimeve shtetërore të Serbisë gjatë fushatave parazgjedhore. Lideri i Aleancës Kosovare, Goran Marinkoviq, tha më 22 dhjetor se, aktualisht, prioriteti kryesor është siguri i paqes në Kosovë, e më pas stabilizimi i ekonomisë, në mënyrë që qytetarët të kenë një ekzistencë të sigurt. Nga Aleanca Kosovare u tha gjithashtu se problemi më i madh në veri të Kosovës është siguria dhe se, për këtë arsye, një

numër i madh i pjesëtarëve të komunitetit serb janë shpërngulur. Kjo parti ka deklaruar më herët se ka tentuar të bisedojë për krijimin e një koalicioni më të gjerë të partive opozitare serbe për zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit, por se këto përpjekje kanë përfunduar pa sukses. Në zgjedhjet e së dielës, të drejtën e votës do të mund ta ushtrojnë mbi dy milionë shtetas të Kosovës. Në zgjedhje do të marrin pjesë 24 subjekte politike me gjithsej 1.180 kandidatë.

LIGJI I SHBA-së PËR SIGURINË NË BALLKAN DHE EVROPË NË RENDIN E RI NDËRKOMBËTAR: KONSOLIDIMI I HAPËSIRËS SHQIPTARE SI IMPERATIV STRATEGJIK DHE FAKTOR STABILITETI



Nga Washington, D.C.
Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

I. Fundi i iluzioneve dhe lindja e rendit të ri ndërkombëtar

Rendi ndërkombëtar liberal i pas Luftës së Ftohtë, i ndërtuar mbi parimin e globalizimit të pakushtëzuar, dialogut universal dhe reduktimit të rolit të forcës, ka hyrë në fazën e tij përfundimtare. Ngjarjet e dekadës së fundit - agresioni rus në Ukrainë, militarizimi i politikës së jashtme, lufta hibride, energjia si armë politike dhe fragmentarizimi i sistemit ndërkombëtar - kanë prodhuar një rend të ri ndërkombëtar, ku siguria, aleancat dhe besueshmëria strategjike janë kthyer në vlera themelore. Në këtë realitet të ri, Ligji i Shteteve të Bashkuara për Sigurinë në Ballkan dhe Evropë

nuk është një reagim i rastësishëm, por pjesë e një doktrine të re amerikane, që synon konsolidimin e aleatëve të qëndrueshëm dhe eliminimin e zonave gri të sigurisë.

II. Ligji amerikan si instrument i rendit të ri të sigurisë

Në rendin e ri ndërkombëtar, ShBA-ja nuk investon më në balancime artificiale, por në blloqe funksionale të besimit strategjik. Ligji për sigurinë në Ballkan: forcon kapacitetet mbrojtëse të aleatëve, mbështet rezistencën institucionale ndaj ndikimeve autoritare, dhe e trajton Ballkanin Perëndimor si pjesë integrale të sigurisë euro-atlantike. Ilustrim konkret: Ashtu si Polonia dhe shtetet baltike u shndërruan nga periferi post-komuniste në shtylla të sigurisë

lindore të NATO-s, edhe Ballkani Perëndimor po hyn në të njëjtën logjikë strategjike. Brenda këtij procesi, hapësira shqiptare paraqet koherencën më të lartë politike dhe ushtarake.

III. Korniza juridike: Sovraniteti funksional në shekullin XXI

Sovraniteti në shekullin XXI nuk matet më vetëm me kufij, por me aftësi për të prodhuar siguri, stabilitet dhe besueshmëri ndërkombëtare. Ligji amerikan është plotësisht në përputhje me: Kartën e OKB-së (neni 52 - marrëveshjet rajonale), praktikën e NATO-s, dhe integrimet funksionale evropiane. Ilustrim krahasues: Bashkëpunimi i thelluar franko-gjerman pas Luftës së Dytë Botërore nuk e dobësoi sovranitetin e këtyre shteteve, por e forcoi atë. Në mënyrë

analoge, bashkërendimi Shqipëri-Kosovë nuk cenon rendin juridik, por e përforcon atë.

IV. Dimensioni diplomatik: Faktori shqiptar si aleat strategjik

Në rendin e ri ndërkombëtar, diplomacia nuk matet me neutralitet, por me qëndrueshmëri të aleancave. Shqiptarët, historikisht dhe aktualisht, përfaqësojnë: orientim të qartë pro-amerikan, përputhje të plotë me politikën e NATO-s, dhe mbështetje të vazhdueshme për rendin perëndimor. Ilustrim historik: Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë më 1999 dhe mbështetja e pakursyer amerikane për shtetndërtimin e Kosovës krijuan një marrëdhënie besimi strategjik, e cila sot po institucionalizohet përmes ligjeve dhe doktrina të reja të sigurisë.

V. Konsolidimi i hapësirës shqiptare: nga fragmentarizimi drejt funksionalitetit

Fragmentarizimi i hapësirës shqiptare ka qenë historikisht burim dobësie strukturore. Rendi i ri ndërkombëtar nuk toleron aktorë të fragmentuar, por favorizon njësi funksionale, të koordinuara dhe të parashikueshme. Konsolidimi i hapësirës shqiptare nënkupton: politika të përbashkëta të sigurisë, koordinim diplomatik ndërkombëtar, integrim ekonomik dhe energjetik, dhe harmonizim institucional. Ilustrim praktik: Siç vepron sot Boshti Nordik (Norvegji-Suedi-Finlandë) në fushën e sigurisë, edhe hapësira shqiptare mund të funksionojë si njësi strategjike brenda NATO-s, pa ndryshuar

kufij dhe pa krijuar tensione.

VI. Hapësira shqiptare si një e siguri euro-atlantike

Ballkani Perëndimor po kalon nga zonë tranzicioni në front të sigurisë evropiane. Në këtë realitet, shqiptarët përfaqësojnë: elementin më pro-perëndimor, faktor stabilizues ndër-etnik, dhe partner të besueshëm të ShBA-së. Ligji amerikan e pozicionon këtë hapësirë jo si problem, por si zgjidhje strategjike për rajonin.

VII. Dimensioni historik: drejt korrigjimit funksional të padrejtësive

Pa hyrë në narrativa revizioniste, rendi i ri ndërkombëtar pranon se stabiliteti nuk ndërtohet mbi padrejtësi funksionale. Konsolidimi i hapësirës shqiptare përfaqëson një korrigjim funksional, jo territorial, të padrejtësive historike.

VIII. Nga mbijetesa drejt rolit strategjik

Ligji i ShBA-së për Sigurinë në Ballkan dhe Evropë është më shumë se akt ligjor: ai është platformë strategjike e rendit të ri ndërkombëtar. Brenda kësaj platforme, hapësira shqiptare ka potencialin të shndërrohet në: bosht stabiliteti, garantues sigurie, dhe partner kyç transatlantik. Ky proces nuk është projekt emocional apo ideologjik, por domosdoshmëri strategjike e shekullit XXI, në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe interesat e paqes globale.

Musliu: Serbia po shantazhon kandidatë serbë nga Kosova për të imponuar votën për Listën Serbe

PRISHTINË, 26 DHJETOR- Eksperti i sigurisë, Agim Musliu, ka deklaruar se dy kandidatë të larguar nga partia "Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë" e Nenad Rashiqit, sipas të gjitha gjasave, janë ndaluar në Serbi nga institucionet e sigurisë serbe. Sipas tij, gjatë ndalimit ndaj tyre është ushtruar presion i jashtëzakonshëm, duke i detyruar të dalin publikisht me deklarata për largimin e tyre nga subjekti politik. "Nëse nuk do ta bënin këtë, do të arrestoheshin apo do të

përballeshin me pasoja edhe më të rënda", ka shkruar Musliu në "Facebook". Ai ka vlerësuar se kjo përfaqëson mekanizmin përmes të cilit presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, i detyron serbët e Kosovës të votojnë në funksion të interesave të Serbisë, konkretisht për Listën Serbe. "Vuçiq krenohet me këtë veprim, por të gjithë e dinë, ose duhet ta dinë, se kjo përbën një krim të rëndë ndaj një qytetari dhe një ndërhyrje flagrante në zgjedhjet në Kosovë", ka shtuar ai.

Musliu ka bërë të ditur se familjarët dhe rrethi i ngushtë i Nikolçeviçit janë plotësisht të informuar për presionin e ushtruar ndaj tij, si dhe për faktin se ai nuk ka pasur asnjë mundësi reale për ta kundërshtuar apo denoncuar këtë presion, as pas largimit nga Serbia. "Këto janë metoda brutale shantazhi të stilit rus, të cilat Serbia po i aplikon sistematikisht ndaj serbëve të Kosovës dhe, në mënyrë direkte, ndaj vetë Kosovës", ka përfunduar Musliu.



Mbi 90 mjekë dhe 192 infermierë lëshuan Kosovën më 2025

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Mungesa e kushteve të punës e pakënaqësitë më paga kanë bërë që shumë profesionistë shëndetësor të largohen në Kosovë.

Avazi i largimeve ka vazhduar edhe gjatë vitit 2025.

Ani pse krahasuar me vitet paraprake numri mjekëve e profesionistëve tjerë shëndetësor të cilët janë larguar ka rënë, kjo dukuri vazhdon të jetë shqetësuese për Odën e Mjekëve. “Statistika nuk janë të sakta asnjëherë për arsyen se

koha e liberalizimit të vizave ka lehtësuar kushtet dhe rrethanat që lëvizja e lirë të ndodhë. Megjithatë, në krahasim me vitet e tjera është rendi në rënie, por nuk është ndonjë diferencë e madhe, është duku rreth 20 më pak. Këtë vit kanë kërkuar certifikatë të sjelljes së mirë në Odën e Mjekëve rreth 90 mjekë”, thotë për Tëvël, Naser Gjonbalaj nga Oda e Mjekëve.

Sipas nënkryetarit të kësaj Ode, pjesa dërmues e atyre që janë larguar janë mjekë të përgjithshëm.

E jo vetëm mjekët, Kosovën e kanë braktisur edhe infermierët. “Këtë vit infermierë gjithsejtë kanë kërkuar 192, licenca të plastifikuara, dokument i cili ju nevojitet, për ta dërguar në vendin ku ata ushtrojnë profesionin shëndetësor. Me vitin 2024, është një rënie mirëpo trendi po vazhdon”, shprehet Nexhmije Gori, kryetare e Odës së Infermierëve.

Madje sipas kryetares së Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë në Kosovë, Tëvdie Imeri, largimi i profesionistëve

shëndetësor është shqetësues. Prandaj kryetarja e kësaj Federate, kërkon që të ndërmerren masa. “Është hala me shqetësuese se pse një kuadër të përgatitur kaq shumë të shkojë i përgatitur në një vend tjetër ndërsa ju e dini shumë mirë se sa i duhet investim për me nxjerr një doktor të përgjithshme e pastaj të mos flasim për specializant. E gjithë kjo kosto që i kushton familje dhe në fund të fundit po ja dërgojmë një produkt të gatshëm. Ish dashtë të bëhet një



strategji për ndaljen e ikjeve të punëtorëve shëndetësor, pasi Kosova mund të mbetet shumë keq pas pak kohe”, thotë ajo. Sipas Odës së Mjekëve të Kosovë, Gjermania vazhdon të jetë destinacioni i profesionistëve shëndetësor.

AMBASADORI I FRANCËS, OLIVIER GUEROT: NA DUHET NJË QEVERI ME KOMPETENCA TË PLOTA NË KOSOVË

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Na duhet një qeveri me kompetenca të plota, thotë ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guerot.

Tri ditë para zgjedhjeve të 28 dhjetorit, ai deklaroi për “KosovaPress” se

ndërkombëtarëve iu duhet një partner në Kosovë, për të punuar për Planin e Rritjes së BE-së, normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe për zhvillimin e Kosovës. Diplomati francez mirëpret largimin e 50 për qind të masave ndëshkuese ndaj Kosovës, derisa është më i rezervuar në pyetjet se a do të hiqen të njëjtat në tërësi në fillim të vitit të ardhshëm. “Mesazhi është se na duhet një partner. Ne së bashku jemi mbështetës të tuaj të huaj, miqtë tuaj të huaj. Na duhet një qeveri, një qeveri e plotë, me të cilën do të mund të punonim për Planin e Rritjes, natyrisht, por edhe për shumë çështje të tjera, qoftë për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, por edhe për zhvillimin e Kosovës, legjislacionin e Kosovës”, thekson ai.

Kosova nuk arriti të formojë institucionet e reja pas zgjedhjeve të kaluara të 9 shkurtit.

Duke folur për krizën politike



dhe mosformimin e institucioneve, diplomati francez thotë se një vit pa një qeveri me mandat të plotë ka qenë i vështirë për Kosovën. “Ky vit pa një qeveri të plotë ka qenë pak i vështirë, duhet ta them. Jo se nuk kemi qenë në gjendje të punonim, siç thashë, në projektin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza. Ne kemi mundur të punojmë në nivel teknik. Kishte edhe iniciativa të tjera që mund t'i bënim në nivel teknik, por

Kosova është një demokraci. Si demokraci, është nevoja për një qeveri të përgjegjshme para parlamentit”, thekson ai. Bashkimi Evropian ditë më parë vendosi të heqë 50 për qind të masave, derisa u zotua për heqjen e të gjitha masave ndëshkuese ndaj Kosovës deri në fund të muajit janar 2026. Ky zhvillim, sipas ambasadorit Guerot, është lajm i mirë për Kosovën, pasi do të ecin përpara shumë projekte të rëndësishme për vendin, të

cilat ishin bllokuar vitet e fundit. “Kemi një projekt shumë të rëndësishëm, që është ngadalësuar nga masat, për ndërtimin e një impianti të trajtimit të ujërave të zeza, i cili do të mbulonte Prishtinën, Obiliqin, Fushë Kosovën dhe Graçanicën. Ky është një projekt i përbashkët me Gjermaninë, në fakt. Pra, po pres me padurim që të përshpejtojmë këtë projekt, për të cilin nuk jemi ndalur së punuari kurrë në nivelin

technik. Është vetëm një nga projektet që kemi. Kemi projekte të zhvillimit me Agjencinë Franceze të Zhvillimit, sidomos për të ndihmuar Kosovën me Lojërat Mesdhetare 2030 dhe gjithashtu për ta ndihmuar atë në tranzicionin drejt një energjie më të pastër. Në Prishtinë këtu po shohim mjegullën, që është bërë si shkak i një energjie të papastër dhe agjencia po punon”, shton ai.

Sa i përket zotimit se deri në janar të vitit 2026 do të hiqen masat, ambasadori francez thotë për “KosovaPress” se vendimi politik tashmë është marrë nga Këshilli Evropian dhe se tani i takon Komisionit Evropian ta zbatojë. “Detajet nuk i di. Nuk mund t’jua tregoj. Vendimi politik është marrë nga Këshilli i Ministrave dhe nga Këshilli Evropian dhe tani Komisioni do ta zbatojë atë. Prandaj nuk mund të hyj në detaje”, thotë ai.

Masat ndaj Kosovës ishin vendosur në vitin 2023, si përgjigje ndaj përshkallëzimit të situatës së sigurisë në veri të Kosovës, kur kryetarët shqiptarë, të dalë nga zgjedhjet që u bojkotuan nga serbët lokalë, nisën detyrën e tyre në komunat në veri.

Kamberi dorëzon propozim për shuarjen e Qendrës Humanitare serbo-ruse në Nish

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Në kuadër të grupit parlamentar me SDA e Sanxhakut dhe Lëvizjen e Qytetarëve të Lirë (PSG), deputeti Shaip Kamberi ka dorëzuar në Kuvendin Popullor të Serbisë propozimin për shfuqizimin e ligjit që ratifikon marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Serbisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse për themelimin e Qendrës Humanitare Serbo-Ruse në Nish.

Pas 13 vitesh funksionimi, sipas Kamberit, nuk ka prova që qendra ka vepruar në interes të



qytetarëve të Serbisë apo ka luajtur rol të rëndësishëm në përballimin e fatkeqësive natyrore. Përkundrazi,

veprimtaria e saj është karakterizuar nga mungesa e transparence, paqartësi rreth financimit dhe dyshime serioze

për rol politik dhe të sigurisë, si brenda vendit, ashtu edhe në rajon.

Një tjetër shqetësim i shprehur ka qenë tentativa për t'i dhënë qendrës dhe stafit të saj status diplomatik dhe imunitet, çka nuk përputhet me praktikën standarde të misioneve humanitare.

Ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë kanë paralajmëruar se struktura të tilla mund të përdoren për veprimtari inteligjente dhe destabilizuese, sidomos pranë objekteve strategjike.

Sipas Kamberit, hulumtimet e gazetarëve investigativë tregojnë se persona të lidhur me shërbimet ruse të inteligjencës dhe grupe paramilitare në Serbi kanë marrë pjesë në trajnime për nxitjen e trazirave gjatë zgjedhjeve në Moldavi dhe Rumani.

Shfuqizimi i ligjit synon të largojë dyshimet ekzistuese dhe të përshpejtojë rrugën evropiane të Serbisë, pasi qendra ka qenë objekt kritikash në raportet e Komisionit Evropian dhe institucioneve të tjera të Bashkimit Evropian.

Një miliard euro rrymë të importuar në dekadën e fundit, Sllovenia furnizuesi kryesor i Kosovës

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Kosova ka shpenzuar mbi një miliard euro për import të energjisë elektrike nga viti 2017 deri në nëntor 2025, duke thelluar varësinë nga tregjet e jashtme dhe duke krijuar një deficit të madh tregtar në sektorin e energjisë. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, në të njëjtën periudhë eksportet e energjisë kanë arritur vetëm 367.4 milionë euro, çka ka

krijuar një bilanc negativ prej rreth 675 milionë eurosh, shkruan REL. Gjatë dekadës së fundit, Sllovenia ka qenë furnizuesi kryesor i energjisë elektrike për Kosovën, me mbi 375 milionë euro energji të eksportuar drejt vendit. Pas saj renditen Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, ndërsa importet nga vende si

Bullgaria, Greqia, Zvicra, Kroacia dhe Danimarka kanë qenë dukshëm më të ulëta. Viti 2022 shënon kulmin e importit, me mbi 218 milionë euro energji të blerë, ndërsa edhe viti 2025 (janar-nëntor) paraqet rritje të ndjeshme, me 247.8 milionë euro importe, niveli më i lartë i regjistruar deri tani. Ndërkohë, eksportet kanë qenë

të paqëndrueshme dhe shumë më të ulëta krahasuar me importet. Përfundimisht në vitin 2024, kur eksportet arritën në 150.7 milionë euro, duke iu afruar për herë të rrallë vlerës së importeve vjetore. Megjithatë, kjo rritje nuk ka mjaftuar për të përmbysur trendin afatgjatë të deficitit. Të dhënat nxjerrin në pah varësinë strukturore të Kosovës



nga importi i energjisë elektrike, veçanërisht në vitet me prodhim të ulët vendor dhe çmime të larta në tregjet ndërkombëtare.

TATIMI NË PRONË DERI 300%? NGA 1 JANARI NË FUQI LIGJI QË PO FRIKËSON BIZNESET

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Nga 1 janari sipas ligjit të ri do të nisë të zbatohet norma progresive e tatimit në pronë. Në bazë të ligjit pritet që pronave komerciale t'u rritet tatimi, siç thuhet, deri 300%. Në këtë situatë, kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, përmend ambientin e rënduar në Kosovës për bizneset. "Mes shumë sfidave që ka kaluar biznesi, sfida e radhës është edhe kjo, ligji i ri për tatimin në pronë që rrezikon bizneseve tu rritet tatimi në pronë deri në 200-300%...", tha Rafuna për RTV21. Qeveria në vitin 2024 përmes ligjit për buxhetin kishte prolonguar ligjin e ri për tatimin në pronë për janarin e viti 2026.



Arsyetimi i ministrisë për shtyrjen e zbatimit të këtij ligji lidhet mos funksionalizimin e sistemit që bënë përlogaritjet e reja. Ndërkohë, në këtë situatë ish-ministri i financave Haki Shatri përmend sfidat që ka

shtyrja e serishme e këtij ligji. "Këta atë vit e shtynë ligjin përmes ligjit për buxhetin, dihet që atëherë kanë pasur 51% dhe ajo arroganca e numrave edhe ndodhi qysh ndodhi u prolongua. Tash prapë përmes

ligjit për buxhetin në një nen të veçantë kanë vendosë me e shty, por, zvarritja që bënë në mosfromimin e institucioneve dhe shkuarja sërish në zgjedhje rrezikon që bizneset kësti i parë i tatimit në pronë t'i prekë me dyfish apo trefish më shtrenjtë bizneset...", tha Shatri. Aktualisht shkalla tatimore për pronat komerciale është 0.17% e vlerës së pronës. Në bazë të shkallës tatimore progresive komunat kanë hapësirë që të tatimojnë një pronë prej 0.10% të vlerës së saj deri në 1%. Në këtë mënyrë nëse vlera e një prone biznesore është 7 milionë euro dhe e njëjta me ligjin aktual ka paguar tatim rreth 12 mijë euro me shkallën tatimore progresive i bie të paguaj tatim

mbi 26 mijë euro. Ndërkohë për pronat me vlerë mbi 100 milionë euro, bizneset do të paguajnë tatim minimalisht rreth 600 mijë euro. Në gjithë situatën e krijuar, shqetësimi kryesor për bizneset mbetet mos formimi i institucioneve të cilat do të mund të adresonin sfidën e radhës që i pret bizneset për këtë çështje. "Rreziku është që s'ka institucione dhe ligji do të hyjë në fuqi pa pasur mundësi të ndërrohet...", tha Kushtrim Ahmeti nga dhoma e tregtisë. Taksa progresive e tatimit në pronë e cila shtrenjton tatimin në pronë për bizneset deri në 200% u tha se ndikon negativisht edhe tek investitorët e huaj për të cilët vlerësohet se Kosova ka nevojë të madhe.

DEFICITI TREGTAR NË MUAJIN NËNTOR 469 MILIONË EURO, OEK-U: PASQYRË E GJENDJES EKONOMIKE

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Gjatë muajit nëntor, vlera e mallrave të cilat i prodhuam i shitëm në shtetet tjera, e mbuloi vetëm 15.7% të vlerës së mallrave që importuam nga vendet tjera. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave deficiti tregtar ishte fiks 469.9 milionë euro, pra eksportuam 87.7 milionë euro mallra, ndërsa importuam ose blemë nga shtet të tjera mallra në vlerë 557.6 milionë euro. Sikurse çdo vit e muaj pas luftës, edhe gjatë nëntorit 2025 ekonomia vendore ka vazhduar të operojë me deficit, pra shumëfish më shumë kemi blerë mallra sesa që kemi prodhuar dhe shitur në vendet tjera. Të dhënat e Agjencisë së Statistikave tregojnë se diferenca negative në favor të importit është pothuajse 470 milionë euro.

Eksporti i mallrave në muajin nëntor 2025 kishte vlerën 87,7 milion Euro, ndërsa importi 557,6 milion Euro. Eksporti ka shënuar rënie për 9,5%, ndërsa edhe importi është ulur për 1,6%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Eksporti e mbulon importin vetëm me 15.7%, pra gati 85% është diferenca negative e raportit eksport-import. Metalet bazë e përbëjnë mbi 20% të eksportit, ndërkaj tek importi makineritë dhe pajisjet mekanike e elektrike e përbëjnë mbi 13% të sasisë. Mbi 30% e eksportit shkon në Bashkimin Europian, e po ashtu mbi 43% të importit gjatë nëntorit erdhi nga 27 vendet anëtare të Unionit Europian. Oda Ekonomike e Kosovës e ka pritur me shqetësim këtë raport duke vlerësuar se është pasqyrues i qartë për gjendjen e



keqe në të cilën ndodhet ekonomia dhe prodhuesit vendor. "Në qoftë se i shohim të dhënat e 11-mujorshit të vitit të kaluar me 11-mujorshin të këtij vitit shohim se importi po rritet, ndërsa eksporti ka ra dhe p.sh. mbulueshmëria është vetëm

13%, e deficitit tregtar kurse në vlera e kemi mbi 5 miliardë deficitin tani që nuk e mbulojmë me eksportin", ka deklaruar Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike. Sipas kryetarit të Odës Ekonomike përkundër

parashikimeve shumë optimiste nga institucionet vendore mesatarja reale e rritjes ekonomike për këto 11 muaj është rreth 3.4%. Sipas të dhënave zyrtare të ASK-së, inflacioni për muajin nëntor ka arritur në 5.3%. /RTVD/

Qeveria ndan nga 100 euro për fëmijët dhe pensionistët


PRISHTINË, 25 DHJETOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka njoftuar se Qeveria do të ndajë nga 100 euro për të gjithë fëmijët dhe pensionistët me rastin e festave të fundvitit. "Me 28 dhjetor fitojmë bindshëm dhe festojmë, pastaj

me 29 dhjetor gëzohen të gjithë fëmijët e pensionistët. Sepse me fitoren tonë, Viti i Ri vjen më herët. Sikurse çdo vit, edhe sivjet kemi vlerësuar të mbështesim fëmijët dhe pensionistët me shtesat e fundvitit prej 100 eurove", ka shkruar Kurti në

"Facebook". Ai ka thënë se kanë bërë të pamundurën për të siguruar mbështetjen për pensionistët dhe fëmijët pavarësisht mos votimit të buxhetit. "Mosvotimi i buxhetit nga opozita na e ka vështirësuar punën tejmase,

mirëpo ne e kemi bërë të pamundurën që edhe këtë vit të sigurojmë mbështetjen e fundvitit, e cila do të procedohet para natës së Vitit të Ri. Urime festat e fundvitit, dhe t'i gëzoni bashkë me familjet tuaja", ka thënë Kurti.





QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

ZYRTARE: LINDON EMERLLAHU TRANSFEROHET TE POLISSYA ZHYTOMYR

ZHYTOMYR, 25 DHJETOR - Mesfushori i Kombëtares së Kosovës, Lindon Emërllahu tashmë është futbollisti më i ri i skuadrës nga Ukraina, Polissya Zhytomyr. Ekipi që është pjesë e elitës së futbollit ukrainas, të enjten e ka prezantuar Emërllahun, i cili te FC Polissya do ta bartë fanellën me numrin 14. Emërllahu me ekipin e ri ka firmosur kontratë trevjeçare, ndërsa te Polissya Zhytomyr është transferuar nga Cluji i Rumanisë. “Këtë sezon mesfushori luajti 24 ndeshje, duke i shënuar katër gola dhe duke i bërë dy asistime për CFR Cluj në Rumani. Emërllahu është reprezentues i Kosovës. Ka luajtur 12 ndeshje për ekipin nacional, duke shënuar një gol”,

ka shkruar klubi ukrainas në prezantimin e Emërllahut. Për transferimin e Emërllahut, Polissya është thënë se i ka paguar Clujit 1.5 milion euro kurse mesfushori do të ketë pagë vjetore që shkon deri në 500 mijë euro me bonuse. Emërllahu në shkurt të këtij viti iu bashkua Clujit nga Ballkani për 700 mijë euro, ndërsa për ekipin nga Rumania, kampionat ku 23-vjeçari ishte prej mesfushorëve më të mirë, ai ka regjistruar 41 ndeshje në total. Krahas Emërllahut, Polissya Zhytomyr në afatin kalimtar të dimrit synon edhe transferimin e futbollistit tjetër të Kosovës, mbrojtësit Ilir Krasniqi, i cili është pjesë e skuadrës Kolos që po ashtu garon në Superligën e Ukrainës.



MANAJ: GOLI NË SERBI ISHTE NJË NGA MOMENTET MË TË BUKURA NË KARRIERËN TIME



TIRANË, 25 DHJETOR - Sulmuesi i Kombëtares, Rey Manaj ka “hapur zemrën” për golin kundër Serbisë, pak nga femijëria e tij si dhe marrëdhënien me familjen. Në një intervistë të shkurtër me Blendi Fevziun për “Opinion Tv”, Manaj ka shpjeguar se në duelin me Serbinë në të cilin humbi penalltinë e ka përjetuar “peshën” e zhgënjimit të skuadrës dhe tifozëve. Ndërsa goli i i bërë kundër tyre në sfidën e fundit, ishte përtej të bukurës.

“Ishte e rëndë humbja e penalltisë, por goli në Serbi ishte një nga momentet e mia më të bukura të karrierës, por besoj edhe jashtë futbollit ishte kënaqësi e madhe për çdo lloj shqiptari. Kam hyrë në moshën 6-vjeçare në fushë dhe kontratën time të parë zyrtare e kam pasur në moshën 16-vjeç”, ka thënë Manaj. Por larg nga fusha pak nostalgjik dhe shumë i përkushtuar për familjen, sulmuesi ka treguar se me rrogën e tij të parë i kishte

kërkuar mamasë së tij që të mos punojë më pasi do të kujdesej ai për prindërit. “Me rrogën e parë hoqa mamasë nga puna i thashë që do të punojë unë. Prindërit janë pjesa më kryesore e imja, janë gjithmonë me mua”, është shprehur Manaj. Ndër të tjera ai tha se edhe U-21 e Italisë e kishte kërkuar, por nuk ka pranuar. Tanimë sytë sipas tij janë tek fitorja me Poloninë, e cila është e vlefshme për fazën e kualifikueseve të Botërorit 2026.

THELLOHET SKANDALI NË FUTBOLLIN TURK, ARRESTOHET PRESIDENTI I FENERBAHÇES

ANKARA, 25 DHJETOR - Presidenti i Fenerbahçes, Sadettin Saran, është arrestuar në Stamboll si pjesë e një hetimi të gjerë për drogën, të mbikëqyrur nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Stambollit. Sipas “TRT”-së, arrestimi ka ardhur pasi analizat mjeko-ligjore të mostrave të flokëve treguan praninë e narkotikëve, një rezultat që Saran e ka mohuar kategorikisht. “Nuk

kam përdorur kurrë drogë dhe do të kërkoj zyrtarisht riezaminim”, ka deklaruar ai, duke këmbëngulur në pafajësinë e tij. Hetimi ka nisur në fillim të dhjetorit dhe deri më tani ka çuar në arrestimin e më shumë se një duzine personash, përfshirë figura të njohura të medias, argëtimit dhe rrjeteve sociale, të akuzuar për prodhim dhe trafikim droge, si dhe vepra



të tjera penale. Shumë prej të ndaluarve janë testuar përmes analizave të gjakut dhe flokëve

për të verifikuar përdorimin e substancave narkotike. Klubi i Fenerbahçes ka reaguar

zyrtarisht duke i dalë në mbrojtje presidentit të tij dhe duke siguruar se funksionimi i klubit nuk do të ndikohet. “Kemi besim të plotë se presidenti ynë do ta kapërcejë këtë proces me mendje të shëndoshë dhe guxim”, është thënë në deklaratën e klubit, duke shtuar se Sadettin Saran “do t’i lërë këto ditë pas dhe do të vazhdojë të punojë me vendosmëri për Fenerbahçen”.

Ramadani pranë rinovimit me Leccen

LECCE, 25 DHJETOR - Ylber Ramadani ka gjasë që të paktën edhe sezonin e ardhshëm të jetë pjesë e skuadrës së Lecces, e cila bën gara në Serie A të Italisë. Mediumet italiane kanë raportuar se javët në vazhdim

janë të rëndësishme për vazhdimin e bashkëpunimit mes Ramadanit dhe Lecces, ekip që ende nuk e ka aktivizuar opsionin e rinovimit. Ramadani ka kontratë me Leccen deri në fund të këtij sezoni kurse ka të

përfshirë edhe mundësinë e vazhdimin për një vit tjetër, por që ende asgjë nuk është zyrtare. Palët do të ulen për të negociuar dhe Lecce është gati t’ia vazhdojë Ramadanit kontratën, pasi mesfushori i Shqipërisë

vlerësohet lart në klub. 29-vjeçari është pjesë e Lecces prej vitit 2023 kur iu bashkua nga Aberdeeni i Skocisë, ndërsa këtë sezon ka 16 paraqitje në total, ku 15 prej tyre i ka në Serie A të Italisë.





Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 29.2 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2025), Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.1289 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS
për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Auditor junior për auditim financiar dhe pajtueshmëri
Numri i referencës:	AJAFP/ZKA/12-12/25
Grada:	ZKA-Z4
Numri i pozitave:	Dy (2)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon UE në mbledhjen e informatave paraprake për auditimet ku angazhohet, për përgatitjen e dosjeve të auditimit dhe punë tjera në lidhje me auditimin;
- Shkrimi i letrave të punës së auditimit të qarta për çështjet e trajtuara dhe sipas standardeve të ZKA-së dhe të njëjtat i dorëzon me kohë të UE;
- Indeksi i letrave të punës për temat (mostrat) dhe fushat e audituara dhe të gjitha dokumentet (edhe ato që merren në Entitete) duhet të jenë në pajtueshmëri me formatin dhe kërkesat e përcaktuar nga metodologjia, që t'i mundësoj UE një rishikim me të lehtë;
- Përfundimi me kohë i letrave të punës, memove të komponentëve dhe të gjitha detyrave sipas kërkesave të UE për t'i arritur planet kohore të aprovuar nga menaxhmenti;
- Ofron bashkëpunim dhe informata të sakta për Ekipin e auditimit, departamentin e tij dhe me të gjithë sektorët dhe departamentet e tjerë në kuadër të ZKA-së;
- Ndihmon stafin tjetër të ekipit dhe të departamentit, rreth punëve audituese, për përdorim të teknologjisë informative, ofron përkrahje UE dhe të jetë përgjegjës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të ekipit dhe të departamentit;
- Komunikim të mirë me anëtarët e ekipit me UE, DD, stafin e ZKA dhe me stafin e entiteteve gjatë auditimit;
- Të ruajë dhe azhurnoj njohuritë profesionale dhe teknike dhe të tregoj gatishmëri për të marrë njohuri të reja nga fusha e auditimit për fushat e dakorduara me UE dhe DD gjatë vlerësimit të performancës për vitin e kaluar, dhe të ndjekë trajnimet e organizuara nga ZKA që lidhen me Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Tregon integritet të lartë dhe vepron në pajtim me Kodin Etik dhe të Mirësjelljes Profesionale, si brenda ashtu edhe jashtë ZKA-së;
- Kryen edhe detyra tjera profesionale që mund të kërkojnë nga UE dhe DD i/e tij.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë, janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomik, juridik, administratë publike, matematikë financiare në banka dhe sigurime ose Inxhinierisë;
- Përvoja profesionale: Dy (2) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë;
- Certifikimi: Të ketë certifikatë si teknik kontabilitetit, asistent-auditor i sektorit publik ose auditor i brendshëm.

Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri në fushën e auditimeve;
- Shkathtësi në organizim të punës dhe përmeshje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- certifikatë për teknik kontabiliteti, asistent-auditor i sektorit publik ose auditim i brendshëm;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **10.01.2026 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. “Ahmet Krasniqi” nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i članovima 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 01/2024 o prijemu i karijeri u Nacionalnoj kancelariji revizije, u vezi sa članom 29.2 Pravilnika (NKR) 03/2024 o klasifikaciji radnih mesta (izmenjeno i dopunjeno Pravilnikom (NKR) br. 03/2025), Godišnjim planom zapošljavanja za 2025. godinu i Odlukom generalne revizorke br. 1289 o popunjavanju slobodnog radnog mesta, Nacionalna kancelarija revizije raspisuje:

KONKURS
za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Pozicija:	Junior revizor za finansijsku reviziju i reviziju usklađenosti
Referentni broj:	AJAFP/ZKA/12-12/25
Rang:	ZKA-Z4
Broj pozicija:	Dva (2)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže VT-u u prikupljanju preliminarne informacije za revizije u kojima je angažovana, u pripremi revizorskih dosijea i drugim poslovima vezanim za reviziju;
- Pisanje revizorskih radnih dokumenata o obrađenim pitanjima i u skladu sa standardima NKR-a i iste blagovremeno dostavlja VT-u;
- Indeksiranje radnih dokumenata za revidirane teme (uzorke) i oblasti i svi dokumenti (i one dobijene od entiteta) moraju biti u skladu sa formatom i zahtevima utvrđenim u metodologiji, kako bi se omogućio lakši pregled od strane VT-a;
- Blagovremen završetak radnih dokumenata, memoranduma o komponentama i svih zadataka u skladu sa zahtevima VT-a kako bi se postigli rokovi koje je odobrilo rukovodstvo;
- Pruža saradnju i tačne informacije revizorskom timu, njegovom odeljenju i svim ostalim sektorima i odeljenjima u okviru NKR-a;
- Pomaže ostalom osoblju tima i odeljenja u revizorskom radu, koristeći informacione tehnologije, pruža podršku VT-u i odgovoran je za obavljanje dužnosti radi postizanja ciljeva tima i odeljenja;
- Dobra komunikacija sa članovima tima, sa VT-om, DO-om, osobljem NKR-a i osobljem entiteta tokom revizije ;
- Održava i ažurira stručno i tehničko znanje i pokazati spremnost za sticanje novih znanja iz oblasti revizije za oblasti dogovorene sa VT-om i DO-om tokom procene učinka za prethodnu godinu, i pohađati obuke koje organizuje NKR koje se odnose na kontinuirano stručno usavršavanje;
- Pokazuje visok integritet i postupa u skladu sa Etičkim kodeksom i profesionalnog ponašanja, kako unutar tako i van NKR-a;
- Obavlja i druge profesionalne zadatke koje mogu zahtevati VT i DO.

Opšti formalni zahtevi za ovu poziciju, u finansijskim i revizijama i revizijama usklađenosti, su:

- Obrazovanje: Univerzitetska diploma ekonomije, prava, javne uprave, finansijske matematike u bankarstvu i osiguranju ili inženjerstva;
- Profesionalno iskustvo: Dve (2) godine stručnog radnog iskustva u reviziji, računovodstvu, finansijama ili administraciji;
- Sertifikacija: Posedovati sertifikat za računovodstvenog tehničara, pomoćnika revizora javnog sektora ili internog revizora.

Potrebne veštine :

- Znanje iz oblasti revizije;
- Veštine u organizovanju posla i ispunjavanju ciljeva;
- Poznavanje pravnih akata koji se primenjuju na Nacionalnu kancelariju revizije;
- Poznavanje efikasnog nadzora profesionalnog rada;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Motivacione i komunikacijske sposobnosti u timu;
- Posedovati dobre međuljudske sposobnosti.

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate se vrši u skladu sa važećim zakonskim propisima.

Postupak prijave:

Postupak prijavlivanja je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna kancelarija revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati moraju da dostave potrebnu dokumentaciju, kao nadole:

- službeni obrazac za prijavu NKR-a;
- kopija lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o obrazovnoj spremi (diploma fakulteta). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- sertifikat za računovodstvenog tehničara, pomoćnika revizora javnog sektora ili internu reviziju;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- dokaz iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne stariji od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa položaja javnog službenika (ako je primenljivo);

Samo službeni obrazac za prijavu će biti uzet u obzir. Dokumenti podneti nakon roka neće biti razmatrani, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (*onlajn*) i na veb stranici Nacionalne kancelarije revizije. Rok za podnošenje dokumentacije je **10.01.2026. u 16:00 časova**.

Obrasci za prijavu mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na www.zka-rks.org i dostaviti Odeljenju za upravljanje dokumentima na adresu: Naselje: Arberia, ul. „Ahmet Krasniqi“ br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 časova, obrazac i prateća dokumentacija mogu se dostaviti i putem e-pošte na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete kontaktirati tel. br. 038/606-004, lok. 1025.

Napomena:

Prijave poslate poštom, koje nose poštanski žig o pošiljci dostavljeno poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće uzete u razmatranje.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare, lidhur me nenin 27.3 Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Punës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2025), Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.1289 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS
për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita: Auditor Senior për auditim të performancës
Numri i referencës: ASAP/ZKA/12-14/25
Grada: ZKA-Z2
Numri i pozitave: Dy (2)
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen auditime sipas planit vjetor, rregullave dhe metodologjisë së ZKA-së, Kodit të Etikës dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe raporton Drejtorit të Departamentit të Auditimit dhe udhëheqësit të ekipit të auditimit;
- Në mënyrë efektive koordinon punën e auditimit me Udhëheqësin e ekipit dhe ofron mbështetje profesionale në ekip dhe në departament;
- Kryen hulumtime dhe analizë për fushën të caktuar dhe bën propozimin e temave audituese për planifikimin strategjik dhe atë vjetor të ZKA-së;
- Pjesëmarrje aktive në parastudim të auditimit, duke përfshirë përshkrimin e fushës, problemin/motivin e auditimit, hartimin e objektivës, pyetjeve audituese, kriterëve të auditimit dhe metodologjisë;
- Përpilimi i anketave/pyetësorëve lidhur me temën audituese (në rast se janë të zbatueshme për auditimin e caktuar);
- Kryerja e detyrave me përgjegjësi, të caktuara nga UE dhe Drejtori i departamentit;
- Raportimi i vazhdueshëm të mbikëqyrësi lidhur me progresin e arritur në auditim;
- Ofron përkrahje profesionale duke kryer hulumtime dhe analiza të të dhënave të mbledhura dhe prezantimin e tyre;
- Nxjerrja konkluzioneve dhe dhënia e rekomandimeve duke u mbështetur në dëshmitë audituese dhe në bazë të gjykimit profesional;
